



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 24.05.2013, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllët rasti më nr. AKK-03-238/13, z. Bajram Kelmendi, Drejtor në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, për shkak se zyrtari i lartë publikë ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e paraparë sipas nenit 18.1 të ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Pas identifikimit të rastit, ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokollit AKK-03-238/13, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Bajram Kelmendi, Drejtor në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, ku është dyshuar për gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit, pasi që ushtron edhe pozitën e personit të autorizuar në biznes privatë.

Agjencia kundër Korrupsionit me datën 21.02.2013, e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejte në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave, zyrtari i lartë z. Bajram Kelmendi, pasi ka kontaktuar me zyrtarët e Agjencisë, ka kërkuar nga ta që të njoftohet me gjerësisht, rreth çështjes së ngritur, sipas procedurës i kemi shpjeguar për fillimin e hetimeve lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari në fjalë e ka potencuar se ushtron funksionin e Drejtor në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, dhe është person i autorizuar në biznesin "KELMENDI GmbH" sh.p.k, ku pronar është vëllai i tij.

Gjatë bisedës zyrtari në fjalë ka pranuar dëshmitë e AKK-së, dhe është zotuar se në afat sa me të shpejtë do të bëjë ndryshimet e kërkuara dhe do ta shmangë çfarëdo situatë që mundë të shkaktoj konflikt të interesit.

Pas kësaj zyrtari i lartë me datën 08.05.2013, ka sjellë në Agjenci dëshmitë e lëshuara nga ARBK-ja, ku dëshmon se ka bërë ndryshimet dhe nuk është me person i autorizuar në biznesin e sipërpërmendur .

Duke u bazuar në dëshmitë e ofruara nga zyrtari i lartë z. Bajram Kelmendi, Drejtor në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, si dhe në gjendjen faktike që gjendet zyrtari Konstatohet se : Zyrtari i lartë z. Bajram Kelmendi, Drejtor në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej pasi që ka bërë ndryshimet e kërkuara dhe nuk gjendet në situatë të papajtueshme me Funkcionin e tij Publik si Drejtor në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

